



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT ME REKOMANDIME

Rasti nr. 717/2019

Veton Elshani dhe të tjerët (175)

në lidhje me mungesën e hetimeve efektive dhe cenimin e dinjitetit të zyrtarëve nën hetim

Drejtuar:

Z. Aleksandër Lumezi, Kryeprokuror
Prokuroria e Shtetit

Z. Exhevit Zuka u. d. Kryeshef Ekzekutiv
Inspektorati Policor i Kosovës

Z. Bahri Hyseni, Kryesues
Këshillit Prokurorial

Kopje:

Z. Xhelal Sfeçla, Ministër në detyrë
Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike

Z. Rashit Qalaj, Drejtor
Policia e Kosovës

Z. Bujar Sadiku, Drejtor i Përgjithshëm
Agjencia për Informim dhe Privatësi

26 maj 2020

Qëllimi i Raportit

Ky Raport, ka për qëllim vlerësimin e aplikimit të parimeve kryesore përkitazi me detyrimet themelore për hetime efektive brenda një afati të arsyeshëm kohor, në një proces hetimor ndaj zyrtarëve policorë (175), të cilët janë përfitues të pensionit/beneficionit financiar të “*Invalidit të Luftës së UÇK-së*”, nën dyshimet se të njëjtit mund të kenë kryer veprën penale “*Mashtrim*”¹.

Raporti vlerëson realizimin efektiv të të drejtave të zyrtarëve policor që kanë përfituar statusin e “*Invalidit të Luftës së UÇK-së*”, në raport me përballjen e tyre me një hetim themelorë joefektiv, i përcjellë në vazhdimësi me shkrime në media pa bazën e një trajtimi/analize adekuate për të garantuar që liria e shprehjes, përkatësisht liria e medieve të mos abuzohet në drejtim të cenimit të dinjitetit të njeriut, privatësisë, përhapjes së gjuhës së urrejtjes, mosdurimit dhe pasojave të tjera të dëmshme.

Raporti argumenton shkeljen e të drejtave të palëve në procedurë penale, nëpërmjet interpretimit të dispozitave ligjore që garantojnë këto të drejta dhe të cilat janë të detyrueshme për organet e drejtësisë, përkatësisht Prokurorinë ;

Kompetenca e Avokatit të Popullit

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (më tej: Kushtetuta); në nenin 132, paragrafi 1, përcakton:

“Avokati i Popullit mbikëqyrë dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike”, kurse në paragrafin 3 përcakton: “Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”

2. Sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit, ndër tjera, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

“Të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e institucioneve përkatëse në lidhje me rastet e tilla.” (Neni 18, par. 1, nënpar. 1.2).

“Të njoftojë Qeverinë, Kuvendin dhe institucionet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit.” (Neni 18, par. 1, nënpar. 5).

“T’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta.” (Neni 18, par. 1, nënpar. 6).

“Të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës.” (Neni 18, par. 1, nënpar. 7).

“Të përgatisë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit dhe të kryejë hulumtime mbi çështjen e të

¹ “Mashtrimi” sipas Kodit nr.04/L-082, Penal të Republikës së Kosovës (mbi bazën e të cilit po pretendohet se janë intervistuar këta të dyshuar) në paragrafin 1 të nenit 335 përcakton: “Përveç siç parashihet në nenin 336 të këtij Kodi, kushdo që me anë të paraqitjes së rreme të fakteve apo duke fshehur faktet dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për veten apo personin tjetër, ose për t’i shkaktuar dëm material personit tjetër, e mashtron apo vazhdon lajthimin e personit tjetër dhe me këtë e nxit një person që të kryej apo të mos kryej një veprim në dëm të pasurisë së tij apo të pasurisë së personit tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet”.

drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës." (Neni 18, par. 1, nënpar. 8).

"T'i rekomandojë Kuvendit harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv." (Neni 18, par. 1, nënpar. 9).

Me dërgimin e këtij Raporti tek institucionet kompetente, si dhe publikimin e tij, Avokati i Popullit synon t'i kryejë këto përgjegjësi kushtetuese dhe ligjore.

Përshkrimi i rastit

3. Rasti është hetuar duke u bazuar në ankesën e zyrtarëve policor (175), ndaj Inspektoratit Policor të Kosovës dhe Prokurorisë së Shtetit përkitazi me pretendimet për cenimet e një game të gjerë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të garantuara me Kushtetutë, me instrumente ndërkombëtare si dhe me ligjet në fuqi.
4. IPK kishte filluar një proces hetimor ndaj një numri relativisht të madh të zyrtarëve policor (175), të cilët janë përfitues të beneficionit financiar të *"Invalidit të Luftës së UÇK-së"*. Në këtë drejtim, rasti në IPK ishte iniciuar nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) nën dyshimet për *"krim të organizuar"*, por meqenëse nuk ishin gjetur elemente të veprës penale në këtë çështje, hetimet ishin vazhduar nga Prokuroria Themelore (PTh) në Prishtinë nën dyshimin se të njëjtit mund të kenë kryer veprën penale *"Mashtrim"* me rastin e pranimi të tyre në Policinë e Kosovës².
5. Gjatë gjithë kohës sa po zhvillohen këto hetime³ asnjëra nga prokuroritë nuk kishin nxjerrë asnjë lloj aktvendimit për fillimin e hetimeve, që nënkupton se bëhet fjalë për fazën parapenale (faza e mbledhjes/grumbullimit të informacioneve). Për më shumë prej vitit 2016, zyrtarët policorë të dyshuar në këtë proces u përballen me shkrime nëpër media⁴ të ndryshme duke u apostrofuar me terma të ndryshëm si *"polic mashtrues"*⁵, *"policët e sëmurë mental"*⁶, *"veteran mashtrues"*⁷ etj.

Veprimet e Institucionit të Avokatit të Popullit, bashkëpunimi dhe qëndrimet e autoriteteve përkatëse

Inspektorati Policor i Kosovës

6. Më 25 shtator 2019, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit zhvilloi takim në IPK, me ç'rast u takua me Udhëheqësin e Departamentit të Inspektimit, (i cili zëvendësohte Kryeshefen e IPK-së) dhe me udhëheqësin e Departamentit të Hetimeve, me të cilët bisedoi lidhur me rastin. Ata e njoftuan se IPK fillimisht ishte njoftuar nga PSRK-ja se ka filluar proces hetimor ndaj këtyre zyrtarëve policor nën dyshimin për kryerjen e veprës penale *"krim i organizuar"*, por meqenëse hetimet e PSRK-së nuk kishin rezultuar me krim të organizuar, çështja kishte kaluar në IPK për të hetuar lidhur me deklarinimin e tyre me rastin e pranimi të policit, pasi që sipas tyre këta zyrtarë nuk kanë deklaruar se janë përfitues edhe të pensionit invalidor. Më tej, sipas tyre në vitin 2017 IPK-ja kishte marrë autorizim nga PTh në Prishtinë, për t'i filluar hetimet mbi bazën e dyshimit për veprën penale *"Mashtrim"*. Në këtë kontekst ata theksuan se IPK-ja kishte

² Zyrtarët policor deklarojnë se janë pranuar në polici në fazat e hershme që nga paslufta dhe ka prej tyre që punojnë në polici nga viti 1999 dhe 2000.

³ Zyrtarët policor japin indikacione se hetimet ndaj tyre kanë filluar para vitit 2015.

⁴ <https://zeri.info/aktuale/117151/ne-polici-punojne-edhe-invalidet-e-luftes/>

⁵ <https://www.periskopi.com/prokurori-clez-blakaj-ishte-ne-lufte-me-94-policet-me-semundje-mendore/>

⁶ <https://www.kosova-sot.info/lajme/303144/clez-blakaj-nuk-ishte-ne-lufte-vetem-me-veteranet-e-lsquo-rrejschem-rsquo-por-edhe-me-policet-e-lsquo-semure-mental-rdquo/>

⁷ Po aty.

rekomanduar Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë suspendimin e këtyre zyrtarëve policor me arsyetimin se nuk janë të aftë për punë . Me kërkesën e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë ishin organizuar ekzaminime mjekësore dhe meqë rezultatet kishin dalë negative, Policia e Kosovës nuk e kishte zbatuar rekomandimin e IPK-së.

7. Në IPK deklaruan ata kishin marrë autorizime shtesë nga PThP, për të parashtruar kallëzime penale ndaj këtyre zyrtarëve policor, por kishin shprehur skepticizëm lidhur me qëndrueshmërinë e akuzës.
8. Më 5 nëntor 2019, Avokati i Popullit i dërgoi shkresë Kryeshefes Ekzekutive të IPK-së, të cilën e njoftoi me shqetësimet e këtyre zyrtarëve policor dhe nga e cila kërkoj të informohet në lidhje me hetimet e zhvilluara nga IPK.
9. Më 20 nëntor 2019, Avokati i Popullit pranoi përgjigje nga IPK-ja, sipas së cilës në fillim të vitit 2017, ishin udhëzuar nga ana e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK), për grumbullimin e informacioneve preliminare lidhur me informacionet për përfitimin e statusit të invalidit të luftës, nga ana e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës. Në këtë drejtim IPK-ja precizon se më 28 korrik 2017, kishin pranuar autorizim nga PSRK-ja (Autorizimi PPN:nr.167/2016), për hetimin e të çështjes së përfitimit të statusit të invalidit të luftës nga ana e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, dhe se numri i pjesëtarëve të policisë lidhur me këtë çështje ishte rreth 150 zyrtarë policor.
10. Më 13 janar 2020, Avokati i Popullit kërkoj informacione shtesë nga IPK-ja, dhe po ashtu u kërkuar që një kopje e autorizimeve të Prokurorisë të lëshuar për IPK-në, t'i përcillet Avokatit të Popullit.
11. Më 5 shkurt 2020, meqenëse nuk u pranua përgjigje, nëpërmjet një shkrese të dytë Avokati i Popullit kërkoj kopjen e këtyre autorizimeve.
12. Më 20 shkurt 2020, Avokati i Popullit pranoi përgjigje nga Udhëheqësi i Divizionit të Hetimit dhe Krimin të Organizuar në IPK, i cili theksoj se është kontaktuar Prokuroria Themelore në Prishtinë respektivisht Kryeprokurori në lidhje me kërkesën e Avokatit të Popullit që t'i përcillet autorizimi Prokurorisë, dhe ai i kishte dhënë udhëzime të prera IPK-së, se asnjë dokument autentik i Prokurorisë të mos shpërndahet për të tjerët për shkak se rasti është në hetim pranë kësaj Prokurorie.

Prokuroria Themelore në Prishtinë

13. Më 18 tetor 2019, përfaqësuesit e Avokatit të Popullit u takuan me ushtruesin e detyrës së Kryeprokurorit në PTh-së në Prishtinë, me të cilin biseduan lidhur me ecurinë e hetimeve në çështjen e të dyshuarve/zyrtar policor. Ai deklaroi se deri atëherë nuk kishte aktvendim për fillimin e hetimeve, nuk kishte kallëzime penale apo ndonjë vendim për pushim të hetimeve (rasti ishte në fazën fillestare të hetimeve), si dhe nuk kishte hetime ndaj përfituesve tjerë të beneficionit financiar të “*Invalidit të Luftës së UÇK-së*” që punojnë në institucione tjera publike (shembull: Zjarrfikësit, Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) Shërbimi Civil, Arsimi, Shëndetësia, Gjykatat, Prokuroritë, etj.). Lidhur me rastin ai kishte sqaruar se fillimisht ishte e ngarkuar një prokurore me këtë lëndë (për të cilën kishte pohuar se është e mbingarkuar me lëndë), prandaj ishte zotuar kjo lëndë me rreth 194 të dyshuar do t'i caktohej një grupi punues prej pesë (5) prokurorëve të cilët do ta hetojnë rastin dhe kishte caktuar datën 8 nëntor 2019, për tu takuar sërish me përfaqësuesit e Avokatit të Popullit dhe për t'i informuar ata me zhvillimet e ngjarjes.

14. Më 8 nëntor 2019, takimi nuk u realizua, ngase sipas sekretares ligjore të kabinetit të Kryeprokurorit, takimi ishte anuluar si pasojë e ngarkesës në punë të Kryeprokurorit.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

15. Më 20 janar 2020, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit u takua me ushtruesin e detyrës së udhëheqësit të Divizionit të Skemave për Kategoritë e Luftës në Departamentin e Familjeve të Dëshmorëve dhe Invalidëve të Luftës (DFIDL) pranë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), me të cilin bisedoi lidhur me çështjen e zyrtarëve policorë. Sipas tij, në vitin 2018, IPK-ja kishte marrë dosjet e 175 zyrtarëve policorë, përfitues të beneficionit "*Invalid i Luftës së UÇK-së*", disa prej të cilave i kanë bërë kopje fizike dhe disa tjera nuk i kanë kthyer ende në DFIDL. Lidhur me numrin e Invalidëve të Luftës së UÇK-së që punojnë në institucione publike, deklaroi se nuk ka të dhëna, por kishte theksuar se secili pjesëtar i FSK-së, Policisë së Kosovës dhe secili zjarrfikës çdo 6 muaj janë të detyruar t'i nënshtrohen ekzaminimeve mjekësore nëse ata janë të aftë për punë në aspektin fizik dhe psikik. Në këtë drejtim, ai kishte theksuar se të njëjtit zyrtarë përfitues të statusit të Invalidit të Luftës së UÇK-së, çdo 1 vit në procedurë rivlerësimi i nënshtrohen vizitave të komisioneve mjekësore në MMPS dhe sipas tij këto komisione vlerësojnë shkallen e invaliditetit e cila te këta zyrtarë policor sillet nga 20% deri në 35%.

16. Lidhur me këtë çështje, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit bisedoi me udhëheqësin e Departamentit të Hetimeve në IPK, me të cilin kishte diskutuar çështjen e vlerësimeve në kuptim të testeve fiziko-psikike të zyrtarëve policorë në çdo gjashtë muaj. Ai kishte deklaruar se këto pretendime janë të paqëndrueshme dhe sipas tij vlerësimet periodike mund t'iu kërkohen vetëm zyrtarëve policorë nga njësitë e specializuara policore.

Policia e Kosovës

17. Më 21 janar 2020, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit u takua me zyrtarë të PK-së, me të cilët bisedoi lidhur me deklaratimet e zyrtarëve të MMPS-së përkitazi me testimet fiziko-psikike çdo gjashtë muaj dhe rivlerësimet nga MPMS-ja. Ata deklaruan se këto pretendime janë të paqëndrueshme dhe njeri prej tyre kishte theksuar se prej se ishte pranuar në Policinë e Kosovës (në vitin 2000) atij asnjëherë nuk i ishte kërkuar një vlerësim i tillë, ndërsa lidhur me vlerësimet e komisioneve mjekësore të MPMS-së kishte deklaruar se ata e vazhdojnë të drejtën në pension përfituesit në baza periodike mbi bazën e shkresave të deponuara kur përfituesit i ishte njohur e drejta në pension dhe jo mbi bazën e rivlerësimit të mëvonshëm.

Baza Ligjore

18. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm *Kushtetuta*) në nenin 3 [Barazia para Ligjit], ndër të tjera përcakton se Republika e Kosovës qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht. Më tej neni 21, paragrafët 2 dhe 3, të Kushtetutës përcaktojnë: "*Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë, Çdokush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve.*"
19. Neni 22 i Kushtetutës përcakton: "*Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike*" kurse neni 23 përcakton: "*Dinjteti i*

njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.”

20. Neni 24 i Kushtetutës, ndalon diskriminimin, duke theksuar që në paragrafin 1, i cili përcakton: *“Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë”*, ndërsa paragrafi 2 i këtij neni përcakton: *“Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personai”*. Tutje neni 26 i Kushtetutës përcakton: *“Secili person gëzon të drejtën e respektimit të integritetit fizik dhe psikik të tij/saj [...]”*.
21. Neni 46 i Kushtetutës, në paragrafin 1, përcakton qartë se: *“E drejta e pronës është e garantuar”*, ndërsa neni 53 i Kushtetutës përcakton: *“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”*
22. Kushtetuta i bën drejtpërdrejt të zbatueshme në rendin ligjor të Kosovës një numër të instrumenteve e marrëveshjeve ndërkombëtare nga fusha e të drejtave të njeriut. Aty është përcaktuar që këto akte zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike, ndër to është edhe Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj.
23. Neni 6 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (4 nëntor 1950), (në tekstin e mëtejshëm: “Konventa”) në paragrafin 1, përcakton: *“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme [...]”*.
24. Neni 10 i Konventës në paragrafin 1 përcakton: *“Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që të kërkojnë licencimin e ndërmarrjeve të transmetimit kinematografike ose televizive”* ndërsa neni 2 përcakton: *“Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor”*.
25. Neni 13 i Konventës përcakton *“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare”*.
26. Neni 14 i Konventës përcakton: *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”*.

27. Ligji nr.04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre (në tekstin e mëtejshëm: “Ligji për Vlerat e Luftës”), në nenin 4 përcakton: *“Varësisht nga njohja dhe rregullimi i statusit, kategorive të trajtuara në këtë ligj, përmes njohjes së të drejtës në pension dhe beneficione të ndryshme do t’ju sigurohet mbështetje financiare dhe benefite të caktuara për kontributin e dhënë në luftën e UÇK-së”*.
28. Sipas nenit 5 të Ligjit për Vlerat e Luftës, pensionet e përcaktuara me këtë ligj janë: pensioni familjar, pensioni invalidor personal dhe pensioni invalidor familjar. Në anën tjetër, neni 9 në paragrafin 1, i cili ndahet në 16 nën paragrafë, përcakton të drejtat dhe beneficionet e invalidëve të UÇK-së.
29. Neni 23, paragrafi 2, i Ligjit për Vlerat e Luftës, përcakton : *“Shfrytëzuesit e pensionit bazë, mund të realizojnë të gjitha të drejtat dhe beneficionet e përcaktuara me këtë ligj, nëse i përmbushin kushtet dhe kriteret sipas dispozitave të këtij ligji”* ndërsa paragrafi 3 përcakton: *“Shfrytëzuesit e personave me aftësi të kufizuara, nuk mund të jenë shfrytëzues të të drejtave nga ky ligj”*.
30. Ligji nr.04/L-261 për Veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm “Ligji për Veteranët e UÇK-së”), në nenin 1 përcakton : *“Qëllimi i nxjerrjes së këtij ligji është përcaktimi i të drejtave në beneficione të Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së), të cilët, me sakrificën, angazhimin dhe kontributin e tyre të çmuar, në Luftën Çlirimtare të Kosovës, ishin faktorë vendimtarë për sjelljen e lirisë dhe pavarësisë për popullin e Kosovës”*.
31. Më tutje, në bazë të nenit 15 të Ligjit për Veteranët e UÇK-së, rregullohet realizimi i të drejtës në pension dhe beneficione, duke përcaktuar që: *“Veterani Luftëtar i UÇK-së, përmes njohjes së të drejtës në pension dhe beneficione të ndryshme, i sigurohet mbështetje financiare dhe benefite të caktuara për kontributin e dhënë në luftën e UÇK-së”*. Ndërsa, neni 16 i Ligjit për Veteranët e UÇK-së, në paragrafin 2 përcakton se: *“Veterani Luftëtar i UÇK-së nuk mund të jetë shfrytëzues i asnjë pensioni nga skemat e tjera pensionale të financuara nga shteti. Nëse Veterani luftëtar është shfrytëzues i ndonjë skeme pensionale të financuar nga shteti në Republikën e Kosovës duhet të përcaktohet se cilin pension do të marrë”*.
32. Ligji nr. 05/L-078 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara në paragrafin 2 të nenit 6A përcakton: *“Vlerësimi i aftësisë së mbetur për punë të personave me aftësi të kufizuara vlerësohet nga Komisioni Mediko-social. Për mënyrën dhe procedurat e vlerësimit të aftësisë së mbetur për punë të personave me aftësi të kufizuara MPMS-ja nxjerrë akt nënligjor”*.
33. Udhëzimi Administrativ (MPMS) nr. 05/2018 për Mënyrën dhe Procedurat e Vlerësimit të Aftësisë për Punë të Personave me Aftësi të Kufizuara në nenin 4 përcakton: *“Të drejtë në aftësim, riaftësim dhe punësim kanë shtetasit e Republikës së Kosovës të cilët janë në moshë prej pesëmbëdhjetë/tetëmbëdhjetë (15/18) deri në gjashtëdhjetepesë (65) vjeç, ku si pasojë e dëmtimit, i takojnë kategorive të personave me aftësi të kufizuara:*

1.1. Invalid i luftës;

1.2. Invalid civil i luftës;

1.3. Invalid i punës (...)

34. Neni 12 i Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 05/2018 për Mënyrën dhe Procedurat e Vlerësimit të Aftësisë për Punë të Personave me Aftësi të Kufizuara përcakton shkallën e zvogëlimit të aftësive në punë si në vijim:

1. *“Bazuar në konstatimin e gjendjes së përgjithshme të personit, Komisioni Mediko-Social përcakton shkallën e zvogëlimit të aftësive për punë, në bazë të shkallës si në vijim:*

1.1. ***Shkallë zero**-nëse personi nuk ka vështirësi dhe pengesa në punë, ose nëse ato janë të papërfillshme dhe nuk ndikojnë në aftësitë e punës (personat me dëmtim dhe zvogëlim të funksionit deri në 29%);*

1.2. ***Shkalla e parë**-nëse vështirësitë dhe pengesat janë të vogla dhe ndikojnë në aftësinë e punës në lidhje me profesionin ose vendet e punës që një person mund të kryejë dhe mundësojë punësimin në kushte të përgjithshme (personat me dëmtim dhe zvogëlim të funksionit në mes të 30-49%);*

1.3. ***Shkalla e dytë**-nëse vështirësitë dhe pengesat janë të moderuara ose të rëndësishme në lidhje me profesionin ose punën që një person mund të kryejë dhe që mundëson punësimin në kushte të veçanta (personat me dëmtim dhe zvogëlim të funksionit në 50-79%);*

1.4. ***Shkalla e tretë**-në qoftë se vështirësitë dhe pengesat janë të plota ose të shumëfishta dhe nëse personi nuk mund të punësohet ose të ketë marrëdhënie pune nën kushtet e përgjithshme ose të veçanta (personat me dëmtim dhe zvogëlim të funksionit 80% e sipër).*

35. Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, në nenin 1 përcakton: *“Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatëzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë”* ndërsa paragrafi 1.1. i nenit 4 të këtij Ligji përcakton: *“Diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji”.*

36. Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës(më tutje: “KPPRK”) në nenin 1 përcakton: *“Me këtë Kod përcaktohen rregullat e procedurës penale të cilat janë të detyrueshme për punën e gjykatave, prokurorisë së shtetit si dhe të pjesëmarrësve të tjerë në procedurën penale të paraparë me këtë Kod”,* ndërsa paragrafi 2 i nenit 3 përcakton: *“Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës”.*

37. Neni 5 i KPPRK-së përcakton: *“ Çdo person i dyshuar ose i akuzuar për veprë penale ka të drejtë të kërkojë procedurë të paanshme penale të zbatuar në kohë të arsyeshme”,* ndërsa paragrafi 2 i nenit 7 përcakton: *“Sipas dispozitave të parapara me këtë Kod, gjykata, prokurori i shtetit dhe policia që marrin pjesë në procedurë penale detyrohen që me vëmendje dhe me përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë të vërtetojnë faktet kundër të pandehurit si dhe ato në favor të tij, dhe para fillimit të procedurës dhe gjatë zhvillimit të saj t’i mundësojnë të pandehurit dhe mbrojtësit të tij shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të të pandehurit”.*

38. Neni 68 i KPPRK-së përcakton: “Sipas këtij Kodi të Procedurës Penale, procedura penale ka katër faza të ndryshme: fazën e hetimit, fazën e ngritjes së aktakuzës dhe deklarimit, fazën e shqyrtimit gjyqësor dhe fazën e mjetit juridik. Procedurës penale mund t’i paraprijnë veprimet fillestare të policisë ose mbledhja e informatave sipas nenit 84 të këtij Kodi” ndërsa paragrafi 4 i nenit 70 përcakton: “Posa policia të ketë dyshim të arsyeshëm se është kryer një veprë penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, policia është e detyruar që brenda njëzet e katër (24) orëve t’i dorëzojë një raport policor prokurorit të shtetit që është kompetent, i cili pastaj vendos nëse duhet filluar procedurën penale”.
39. Neni 101 i KPPRK-së përcakton: “Kur policia apo ndonjë agjenci tjetër qeveritare bën kallëzim tek prokurori i shtetit për një dyshim të arsyeshëm për një veprë, prokurori i shtetit mund të fillojë fazën e hetimit të procedurës penale sipas nenit 102 të këtij Kodi” ndërsa neni 104 përcakton: “Hetimi fillohet me aktvendim të prokurorit të shtetit. Aktvendimi përcakton personin kundër të cilit do të kryhet hetimi, kohën e fillimit të hetimit, përshkrimin e veprës e cila tregon elementet e veprës penale, emërtimin ligjor të veprës penale, rrethanat dhe faktet që e justifikojnë dyshimin e arsyeshëm për veprën penale, nëse masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit apo hetimit janë autorizuar dhe provat me të dhënat e mbledhura deri në atë moment. Një kopje e aktvendimit të hetimit i dërgohet pa vonesë gjyqtarit të procedurës paraprahe”.
40. Paragrafi 2, i nenit 172 i KPPRK-së përcakton: “Policia mban procesverbal për çdo seancë të marrjes në pyetje të personit të arrestuar, duke përfshirë kohën e fillimit dhe të përfundimit të marrjes në pyetje, identitetin e zyrtarit të policisë i cili e ka marrë në pyetje dhe personat tjerë të pranishëm. Kur mbrojtësi nuk ka qenë i pranishëm, kjo shënohet në mënyrë të rregullt në procesverbal” ndërsa paragrafi 4, i po këtij neni përcakton: “Procesverbalet nga paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni i vihen në dispozicion personit të arrestuar dhe mbrojtësit të tij me kërkesën e tyre, në gjuhë të kuptueshme për të arrestuarin”.
41. Kodi nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës (më tutje “KPRK”) në nenin 3 përcakton: “Ndaj kryesit zbatohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale” ndërsa paragrafi 1 i nenit 100 përcakton: “Afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon nga dita kur është kryer vepra penale. Nëse ndonjë pasojë që përbën element të veprës penale shfaqet më vonë, afati i parashkrimit fillon të rrjedh nga ajo kohë”.
42. Ligji Nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit në Nenin 6 [Efikasiteti i Prokurorit të Shtetit] përcakton se “Prokurori i Shtetit ushtron funksionet e veta në mënyrë efektive dhe në pajtueshmëri me Kushtetutën, ligjet e zbatueshme dhe parimet e pranuar ndërkombëtarisht për mos-diskriminimin, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore.” Ndërsa në Nenin 7 paragrafi 1 nënparagrafin 1.6 përcakton se “ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme juridike për zbulimin e veprave penale dhe të autorëve të krimit si dhe hetimin dhe ndjekjen me kohë të veprave penale”
43. Ligji nr. 04/L-076 për Policinë (më tej: “Ligji për Policinë”), në nenin 46 përcakton: “Personeli policor, gëzon të drejta të njëjta civile dhe politike sikurse qytetarët e tjerë, duke iu nënshtruar vetëm kufizimeve në këtë ligj që janë të nevojshme për ushtrimin efektiv të autorizimeve dhe detyrave policore në shoqërinë demokratike” ndërsa paragrafi 2 i këtij neni përcakton: “Personeli policor gëzon të drejta të njëjta sociale dhe ekonomike sikurse shërbyesit e tjerë publikë, siç janë e drejta për të organizuar apo për të marrë pjesë në

organizata përfaqësuese dhe t'i pranojnë shpërblimet e duhura, sigurimin social, ndihmën juridike, benificione shëndetësore dhe benificione të tjera për punën e tyre”.

44. Ligji nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës (më tutje: “Ligji për Inspektoratin Policor”) në nenit 3 përcakton: “Misioni i Inspektoratit Policor të Kosovës është që përmes ushtrimit të veprimtarisë së tij, të sigurojë një shërbim policor të përgjegjshëm, demokratik dhe transparent, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e kërkuara” ndërsa neni 5, përcakton parimet kryesore, prandaj për qëllime të këtij raporti do t'i përmendim vetëm disa prej tyre: paragrafi 2 përcakton: “Punonjësit e IPK-së, në përmbushje të detyrave të tyre, do të respektojnë ligjin në fuqi, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe kontribuojnë në realizimin e tyre”; paragrafi 3 përcakton: “IPK udhëhiqet nga parimet e profesionalizmit, objektivitetit, paanshmërisë politike dhe mos diskriminimit”; paragrafi 7 përcakton: “IPK, duhet t'i zhvillojë hetimet e tyre në mënyrë të saktë dhe të shpejtë, më qëllim të rritjes së besimit në sundimin e ligjit” dhe paragrafi 8 përcakton: “Hetuesit e IPK-së autorizimet e tyre i ushtrojnë në pajtim me Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale”.
45. Neni 6 i Ligjit për Inspektoratin Policor përcakton: “IPK është institucion ekzekutiv në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, e pavarur nga Policia e Kosovës dhe në varësi të drejtpërdrejtë të Ministrit” ndërsa paragrafi 3 i nenit 10 përcakton: “IPK nuk i zbulon Ministrit, autoriteteve publike apo personave tjerë asnjë informacion që ka të bëjë me hetimet duke përfshirë por duke mos u kufizuar edhe në informacionet lidhur me dëshmitaret, bashkëpunëtorët apo informatorët. Informacionet e tilla zbulohen vetëm nga organi i autorizuar sipas Kodit të Procedurës Penale”.
46. Neni 17, paragrafi 1 i Ligjit për Inspektoratin Policor përcakton: “Hetuesit e IPK-së gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, kanë autorizimet policore dhe i ushtrojnë ato në përputhje me Kushtetutën, Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, me këtë ligj si dhe me ligjet dhe aktet nënligjore tjera në fuqi” ndërsa paragrafi 12 i këtij neni përcakton: “Kur IPK konsideron se është në interes të hetimeve, i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë formën e veprimit që mund përfshijë por nuk kufizohet në llojet e suspendimit me pagesë apo transferimin. Rekomandimi duhet të shoqërohet me një deklaratë e cila përmban arsyet e rekomandimit”.
47. Neni 18, paragrafi 4 i Ligjit për Inspektoratin Policor përcakton: “Nëse pas hetimit penal paraprak të një rasti IPK përcakton se ka dyshim të arsyeshëm se punonjësi i policisë që ka qenë subjekt i hetimit, ka kryer veprë penale, IPK bën kallëzim penal dhe ia dërgon Prokurorit së bashku me dëshmitë”.
48. Paragrafi 1, i nenit 9, i Ligjit Nr.2004/38 për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Qytetarëve në Kujdesin Shëndetësor përcakton: “Qytetari ka të drejtë që të pranojë informatën e plotë, në një formular individual” ndërsa paragrafi 2, përcakton: “Qytetari ka të drejtë, që të pranojë informata të detajizuara lidhur me: a), gjendjen e shëndetit të tij, përfshirë këtu edhe vlerësimin mjekësor (...) h) suksesin ose dështimin eventual të çfarëdo ekzaminimi ose intervenimi të përfunduar, përfshirë edhe rezultatet që dallojnë nga ato të pritura, si dhe shkaqet për këtë [...]”.
49. Paragrafi 1, i nenit 20, i Ligjit Nr.2004/38 për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Qytetarëve në Kujdesin Shëndetësor përcakton: “Qytetari ka të drejtë në ruajtjen e konfidencialitetit dhe përmasës private të të dhënave personale, të informatave që janë të lidhura me gjendjen e tij

shëndetësore, trajtimin mjekësor si dhe çdo informate tjetër, që përmban dokumentacioni i tij shëndetësor” ndërsa paragrafi 2 përcakton: “Qytetari, është i autorizuar, që të bëjë deklaratë përkitazi me atë se kush mund të marrë informata mbi sëmundjen e tij dhe prognozën e saj, si dhe kush nuk ka të drejtë të jetë i njoftuar plotësisht ose pjesërisht mbi të dhënat e shërimit të tij”.

50. Ligji nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në nenin 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1, përcakton: “E dhënë personale - çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm (“subjekt i të dhënave”); një person fizik i identifikueshëm është ai, i cili, mund të identifikohet drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, veçanërisht duke iu referuar një identifikuesi në bazë të një emri, një numri identifikimi, të dhënave rreth vendndodhjes, një identifikues online, ose një apo më shumë faktorë specifikë për identitetin fizik, psikologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose social të atij personi fizik”; kurse nënparagrafi 4 i paragrafit 1 të po këtij neni përcakton: “Klasifikim i të dhënave personale—shënjimi i të dhënave personale për të treguar natyrën e tyre të ndjeshme. Për të dhënat e klasifikuara duhet përcaktuar kushtet, sipas të cilave, përdoruesi mund të bëjë përpunimin e tyre. Klasifikimi duhet të mbetet i bashkëngjitur me të dhënat personale të ndjeshme deri në fshirjen, asgjësimin, shkatërrimin ose anonimizimin e tyre”; ndërsa nënparagrafi 25 përcakton: “Të dhëna personale të ndjeshme - të dhëna personale që zbulojnë origjinën etnike ose racore, pikëpamjet politike ose filozofike, përkatësinë fetare, anëtarësimin në sindikatë ose çdo e dhënë për gjendjen shëndetësore ose jetën seksuale, çfarëdo përfshirje në ose heqje nga evidencat penale ose të kundërvajtjeve që ruhen në pajtim me ligjin. Karakteristikat biometrike, gjithashtu, konsiderohen si të dhëna personale të ndjeshme, nëse këto të fundit mundësojnë identifikimin e një subjekti të të dhënave në lidhje me cilëndo nga rrethanat e lartpërmendura në këtë nën-paragraf.” Ndërkaq në nenin 8 të të njëjtit Ligj përcaktohet: “Kategoritë e veçanta të të dhënave personale, duhet të mbrohen në mënyrë të veçantë dhe të klasifikohen me qëllim të parandalimit të qasjes dhe përdorimit të paautorizuar [...]”.

Analiza e rastit

51. Meqenëse nga hetimet e zhvilluara rreth këtij rasti kemi marrë informacione se në fillim të vitit 2017, IPK-ja ishte udhëzuar nga ana e PSRK-së, për grumbullimin e informacioneve preliminare lidhur me informacione për përfitimin e statusit të invalidit të luftës nga ana e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës (shih paragrafin 9) shihet nevoja e një analize komparative ndërmjet Ligjit për Vlerat e Luftës dhe Ligjit për Veteranët e UÇK-së si dhe veprimeve të organeve shtetërore. Ligji për Vlerat e Luftës përcakton që varësisht nga njohja dhe rregullimi i statusit, kategorive të trajtuara në këtë ligj, përmes njohjes së të drejtës në pension dhe beneficione të ndryshme do t’ju sigurohet mbështetje financiare dhe benefite të caktuara për kontributin e dhënë në luftën e UÇK-së.
52. Pensionet e përcaktuara me këtë ligj janë: pensioni familjar, pensioni invalidor personal dhe pensioni invalidor familjar. Në anën tjetër, ky Ligj përcakton të drejtat dhe beneficionet e invalidëve të UÇK-së, duke përcaktuar se kjo kategori ka përparësi në punësim në kushte të barabarta të punës (neni 9, par.1, nënpar.1.8). Për më shumë Ligji për Vlerat e Luftës, përcakton shprehimisht se shfrytëzuesit e pensionit bazë, mund të realizojnë të gjitha të drejtat dhe beneficionet e përcaktuara me këtë ligj, nëse i përmbushin kushtet dhe kriteret sipas dispozitave të këtij ligji dhe precizon që shfrytëzuesit e personave me aftësi të kufizuara, nuk mund të jenë shfrytëzues të të drejtave nga ky ligj. Nga ana tjetër Ligji për Veteranët e UÇK-së, që në nenin 1 përcakton se qëllimi i nxjerrjes së këtij ligji është përcaktimi i të drejtave në

beneficione të UÇK-së, të cilët, me sakrificën, angazhimin dhe kontributin e tyre të çmuar, në Luftën Çlirimtare të Kosovës, ishin faktorë vendimtarë për sjelljen e lirisë dhe pavarësisë për popullin e Kosovës. Më tutje, Ligji për Veteranët e UÇK-së rregullon realizimin e të drejtës në pension dhe beneficione, duke përcaktuar që Veteranit Luftëtar të UÇK-së, përmes njohjes së të drejtës në pension dhe beneficione të ndryshme, i sigurohet mbështetje financiare dhe benefite të caktuara për kontributin e dhënë në luftën e UÇK-së. Tutje, përcaktohet se Veterani Luftëtar i UÇK-së nuk mund të jetë shfrytëzues i asnjë pensioni nga skemat e tjera pensionale të financuara nga shteti dhe në rast se Veterani luftëtar është shfrytëzues i ndonjë skeme pensionale të financuar nga shteti në Republikën e Kosovës, duhet të përcaktohet se cilin pension do të marrë. Bazuar nga analiza e këtyre dy ligjeve vërehet se PSRK-ja, PTh-ja dhe IPK-ja kanë përdorur standarde të dyfishta në situatë të krahasueshme. Në **rastin e parë** (të Veteranëve Luftëtar të UÇK-së), PSRK-ja ka ngritur aktakuzë kundër Komisionit qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të dëshmorit të kombit, invalidit, veteranit, pjesëtarit dhe të internuarit të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, si të dyshuar në cilësinë e personave zyrtarë, ndërsa në **rastin e dytë** (Invalidit të Luftës së UÇK-së) që po e trajton ky raport PSRK-ja, PTh-ja dhe IPK-ja hetimet i kanë drejtuar ndaj individit/zyrtarë policorë-të cilët statusin e invalidit e kanë fituar bazuar në vlerësimin e Komisionit Qendror Mjekësor, i themeluar nga Departamenti Administrativ i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale⁸ e më pas rivlerësuar nga Komisioni Mediko-Social i MPMS-së, në baza periodike por duke u bazuar në shkresat/dosjet e rastit të deponuara në MPMS me rastin e njohjes së statusit, por jo në gjendjen aktuale shëndetësore të përfituesit.

53. Kur flasim lidhur me aftësitë për punë shohim se Udhëzimi Administrativ (MPMS) nr. 05/2018 për Mënyrën dhe Procedurat e Vlerësimit të Aftësisë për Punë të Personave me Aftësi të Kufizuara përcakton shkallën e zvogëlimit të aftësive në punë dhe konstatimin e gjendjes së përgjithshme të personit përmes Komisionit Mediko-Social i cili përcakton shkallën e zvogëlimit të aftësive për punë. Udhëzimi përcakton që “**Shkallë Zero**” kemi nëse personi nuk ka vështirësi dhe pengesa në punë, ose nëse ato janë të papërfillshme dhe nuk ndikojnë në aftësitë e punës, duke precizuar se kësaj kategorie i takojnë personat me dëmtim/ zvogëlim të funksionit deri në 29%. Më tej, Udhëzimi kategorinë e “**Shkallës së Parë**” e përcakton kur vështirësitë dhe pengesat te personi janë të vogla dhe ndikojnë në aftësinë e punës në lidhje me profesionin ose vendet e punës që një person mund të kryejë dhe mundësojë punësimin në kushte të përgjithshme (personat me dëmtim dhe zvogëlim të funksionit në mes të 30-49%). Prandaj nga ajo që u tha më sipër shihet se personat me dëmtim dhe zvogëlim të funksionit deri në 29% mund të mos kenë asnjë lloj pengese në punë. Kjo u argumentua në vitin 2018, kur IPK-ja i kishte rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës suspendimin e 100 zyrtarëve policorë, por ky rekomandim nuk ishte zbatuar sepse Drejtori i Përgjithshëm i Policisë i kishte kërkuar nga ata që të realizojnë kontroll shëndetësorë dhe pas kontrolleve kishte rezultuar se të njëjtit nuk kishin pengesa që ndikojnë në aftësitë e tyre për punë.
54. Në këtë kontekst, KPPRK-ja përcakton rregullat e procedurës penale të cilat janë të detyrueshme për punën e gjykatave, prokurorisë së shtetit si dhe të pjesëmarrësve të tjerë në procedurën penale duke precizuar se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit/dyshuarit. KPPRK-ja përcakton që secili person i dyshuar ose i akuzuar për veprë

⁸ Shih: Rregulloren UNMIK-ut. nr.2000/66, 21 Dhjetor 2000. Mbi Beneficionet e Invalidëve të Luftës të Kosovës dhe për më të afërmit e tyre që kanë vdekur si pasojë e konfliktit të armatosur në Kosovë.

penale ka të drejtë të kërkojë procedurë të paanshme penale të zbatuar në kohë të arsyeshme, duke saktësuar se **organet e shtetit që marrin pjesë në procedurë penale detyrohen që me vëmendje dhe me përkushtim maksimal profesional si dhe me përkujdesje të njëjtë të vërtetojnë faktet kundër të pandehurit si dhe ato në favor të tij, para fillimit të procedurës dhe gjatë zhvillimit të saj.** KPPRK-ja përcakton se procedura penale ka katër faza të ndryshme (*fazën e hetimit, fazën e ngritjes së aktakuzës dhe deklarimit, fazën e shqyrtimit gjyqësor dhe fazën e mjetit juridik*), por **procedurës penale mund t'i paraprijnë veprimet fillestare të policisë ose mbledhja e informatave** (nenit 70). Policia posa të ketë dyshim të arsyeshëm se është kryer një veprë penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, është e detyruar që brenda njëzet e katër (24) orëve t'i dorëzojë një raport policor prokurorit të shtetit që është kompetent, i cili pastaj vendos nëse duhet filluar procedurën penale. Nga sa u tha më sipër shihet se në procedurë paraprake penale, pra para fillimit të hetimit formal, policia vepron me vetiniciativë (sipas detyrës zyrtare) apo sipas autorizimit nga ana e prokurorit të shtetit dhe ka obligim që t'i hetojë veprat penale, si dhe për veprat e hetuara t'i raportojë prokurorit të shtetit sa më shpejt që të jetë e mundur. Në rastin që po e trajton ky raport, bazuar në shkresat e IPK-së (*e cila sipas Ligjit për IPK-në ka autorizime policore*) shihet se ata kanë filluar një hetim parapenal bazuar në një autorizim të PSRK-së të vitit 2016, (ka indikacione se mbledhja e informatave nga IPK kishte filluar vite më parë) dhe ky hetim ka mbetur i pa përfunduar së paku deri në publikimin e këtij Raporti. Një praktikë e tillë e prokurorive dhe IPK-së bie në kundërshtim me vlerat dhe me parimet e tyre, si dhe me praktikën e GJEDNJ-së, pasi që këto institucione me Kushtetutë dhe ligje janë të themeluara për të ofruar drejtësi dhe për t'i mbrojtur të drejtat e qytetarit.

55. Ligji për Inspektoratin Policor përcakton qartë që misioni i IPK-së është që përmes ushtrimit të veprimtarisë së tij, të sigurojë një shërbim policor të përgjegjshëm, demokratik dhe transparent, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e kërkuara. Tuje, aty përcaktohen edhe parimet bazë duke përkufizuar se IPK-ja gjatë përmbushjes së detyrave do të respektojë ligjet në fuqi, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të garantuara me Kushtetutë, si dhe do kontribuojnë në realizimin e tyre. Për më shumë, aty thuhet se IPK-ja udhëhiqet nga parimet e profesionalizmit, objektivitetit, paanshmërisë politike dhe mos diskriminimit, se gjatë ushtrimit të veprimtarisë, ata do të jetë e pavarur, se do t'i zhvillojnë hetimet në mënyrë të saktë dhe të shpejtë, më qëllim të rritjes së besimit në sundimin e ligjit duke precizuar se hetuesit e IPK-së autorizimet e tyre do t'i ushtrojnë në pajtim me KPRK-në dhe KPPRK-në.

Aplikueshmëria e nenit 6 të KEDNJ

56. Lidhur me respektimin e nenit 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, GjEDNJ-ja, nëpërmjet praktikës së saj gjyqësore, ka dhënë interpretimet relevante. GjEDNJ-ja, në rastin *Dimitrov and Hamanov v Bulgaria* (Vendimi i datës 10 gusht 2011), ka theksuar se parimi i procedimit në kohë i garantuar sipas nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka për qëllim të sigurojë besimin e publikut në administrimin e drejtësisë. Qëllimi tjetër i këtij parimi është mbrojtja e palëve në procedurë nga vonesat e tejzgjatura procedurale në çështjet penale, e veçanërisht synon shmangien e faktit që personat e akuzuar të mos qëndrojnë në një situatë të paqartë për fatin e tyre për një kohë të gjatë.⁹
57. GjEDNJ-ja, në rastin tjetër *Boddaert v. Belgium* (Vendimi i vitit 1992), kishte konstatuar se arsyetimi i kohëzgjatjes së procedurës duhet të jetë i determinuar nga kriteret e përcaktuara në

⁹ Rasti Dimitrov dhe Hamanov kundër Bullgarisë, Vendimi i GjEDNJ-së, i datës 10 gusht 2011, paragrafi 70.

praktikën gjyqësore të GjEDNj-së dhe në bazë të karakteristikave të rastit, e cila kërkon një vlerësim të gjithmbarshëm.¹⁰ Për më tepër, GjEDNj-ja, në praktikën e saj gjyqësore lidhur me kohën se kur fillon të rrjedhë afati i tillë, ka dhënë mendimin se ndër rrethana të tjera si pikë fillestare e kohës së fillimit të procedurës merret parasysh data kur hetimet preliminare janë hapur duke vazhduar me rrethana të tjera para se rasti të sillet para gjykatës kompetente.¹¹

58. Po ashtu Gjykata ka theksuar që neni 6 gjen zbatim ndaj tërësisë të procedurave në lidhje me “bazueshmërinë e çdo akuze penale”¹², duke filluar që nga faza e hetimeve të kryera nga ana e policisë¹³, deri tek ajo e caktimit të dënimit¹⁴. Më tej Gjykata Evropiane përcakton se koncepti i “akuzës” duhet të kuptohet/përkufizohet si “*lajmërimi zyrtar lëshuar nga autoriteti kompetent, si kritikë për kryerjen e një vepre penale*”, përkufizim ky që varet gjithashtu nga ekzistenca ose jo e pasojave të rëndësishme për gjendjen e të dyshuarit (shih rastin, *Deweer kundër Belgjikës*, §§ 42 dhe 46, si dhe rastin *Eckle kundër Gjermanisë*, § 73). Kështu për shembull, deklaratat e bëra nga një person gjatë një kontrolli rrugor, ndërkohë që ai nuk ka qenë paralajmëruar për arsyen për të cilën po merrej në pyetje, për natyrën dhe shkakun e dyshimeve që rëndonin mbi të, as për faktin se deklaratat e tij mund të përdoren kundra tij, këto mund të kenë pasoja të rëndësishme për të, me gjithë mungesën e fajësimit formal kundër tij (shih rastin *Aleksandr Zaichenko kundër Rusisë*, § 43). Sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane, neni 3 i Konventës, mund të cenohet si nga keqtrajtimet e paramenduara, e gjithashtu edhe nga neglizhenca apo pasiviteti në ndërmarrjen e hapave specifikë ose mospasigurimi i standardeve të duhura të përkujdesjes. Ky nen imponon shtetit si detyrime negative ashtu edhe detyrime pozitive, domethënë një detyrim për të mos kryer një veprim të caktuar, si dhe detyrimet për të ndërmarrë hapa pozitivë për t’u siguruar individëve respektimin e të drejtave të tyre dhe për t’i mbrojtur ata nga keqtrajtimi.

Prezumimi i pafajësisë

59. Detyrimi i respektimit të dinjitetit të secilit person buron nga kushtetuta, ku në nenin 23 përcaktohet se “Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut”. Mbi këtë bazë, Avokati i Popullit kujton se edhe veprimet dhe vendimet e të gjitha organeve të drejtësisë duhet të jenë në frymën e këtij përcaktimi, si parimi fundamental dhe kornizë e interpretimit të të drejtave themelore të çdo individ, përfshirë edhe palëve në procedurë penale.

60. Mbrojtja e “Dinjitetit të njeriut” është parimi bazë i përcaktuar edhe në dokumentet kryesore ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, siç janë Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut e vitit 1948 (neni 5), Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (neni 7), etj.

¹⁰ Rasti *Boddaert v. Belgium*, Vendimi i GjEDNj-së i vitit 1992, paragrafi 36.

¹¹ The right to trial within reasonable time under Article 6 ECHR, A practical handbook prepared by Ivana Roagna, Këshilli i Evropës, 2018, faqe 17.

¹² Shih rastin *Phillips kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 5.06.2001, nr. 41087/98, § 39;

¹³ Shih rastin *Imbroscia kundër Zvicrës*;

¹⁴ Shih rastin *Findlay kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 25.02.1997. Shih gjithashtu rastin *Aleksandr Dementev kundër Rusisë* ku Gjykata theksoi, në paragrafin 25, se neni 6 gjen zbatim në fazën e caktimit të një dënimi global, pasi ky nuk mund të konsiderohet si një “formalitet ose një ushtrim aritmetik, përderisa gjykatat ruse në caktimin e masës duhet të mbajnë parasysh personalitetin e të akuzuarit si dhe rrethanat lehtësuese ose rënduese në lidhje me veprën e kryer. Madje ajo ka theksuar se neni 6 shtrihet deri në fazën e caktimit të dënimit, edhe kur ky element i procedurës, në praktikën e vendeve të ndryshme, i lihet si kompetencë ekzekutivit me një vendim të posaçëm gjykatë (shih edhe rastin *T. dhe K. Kundër Mbretërisë së Bashkuar*, §§ 106-110.

61. Nuk ka dyshim, se në frymën e këtyre përcaktimeve është edhe KPP, madje në dispozitat e tij edhe shprehimisht përcaktohet obligimi i mbrojtjes së dinjitetit të personit të pandehur në procedurë penale (shih në veçanti nenet 83, parag.6; neni 108, parag.5; dhe neni 154, parag.3).
62. Andaj, Avokati i Popullit, insiston që parimi i mbrojtjes së dinjitetit të personave që janë si të pandehur në procedurë penale, duhet të jetë bazë e të gjitha interpretimeve dhe veprimeve procedurale nga ana e prokurorisë dhe gjykatës.
63. Prezumimi i pafajësisë si parim themelor në procedurë penale, është i përmbajtur në dispozitat e kushtetutës, ku në nenin 31, parag.5 përcaktohet se: "*Çdokush i akuzuar për veprë penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin*". Ndërsa KPP në nenin 3, parag.1, për me tepër precizon se: "*Çdo person i dyshuar ose që akuzohet për veprë penale konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tij me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës*". Si tillë parimi i prezumimit të pafajësisë derivon edhe nga teksti dhe fryma e dokumenteve kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (neni 11, parag.1.) dhe KEDNJ (neni 6, parag.2), të cilat janë të zbatueshme drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës (neni 22 i kushtetutës).
64. Si i tillë, prezumimi i pafajësisë së të pandehurit në procedurën penale të Kosovës, nuk duhet të jetë vetëm i nënkuptueshëm, por duhet të shprehet nga çdo veprim i organeve të drejtësisë, në veçanti në fazën e hetimit dhe ngritjes së aktakuzës. Në raport me rastin e ankuesve dhe raste të tjera në këtë fazë të procedurës, i takon prokurorisë që të kujdeset për ruajtjen e identitetit të personit të dyshuar/akuzuar, dhe vënia në dispozicion e aktakuzës dhe provave që e ngarkojnë, duhet të bëhet gjithmonë para se njoftimi për rastin të publikohet në media.

Liria e shprehjes dhe e mediave

65. Në pajtim me standardin e përcaktuar në dokumentet ndërkombëtare, Avokati i Popullit, tërheq vërejtjen se kufizimet e lirisë së shprehjes arsyetohen deri në masën sa nuk cenohet realizimi i saj dhe vetëm sa është e domosdoshme që kjo e drejtë të mos abuzohet në dëm të të drejtave të tjera. Andaj, arritja e një ekuilibri të tillë kërkon një kujdes të posaçëm, dhe ndërtimin e një kornizë ligjore dhe mekanizmi zbatues të përshtatshëm. Ky synim mund të arrihet vetëm mbi bazën e një trajtimi të thellë dhe analizës për të garantuar që liria e shprehjes, përkatësisht liria e medieve të mos abuzohet në drejtim të cenimit të dinjitetit të njeriut, privatësisë, përhapjes së gjuhës së urrejtjes, mosdurimit dhe pasojave të tjera të dëmshme.
66. Duhet theksuar se me shkrimet ndaj këtyre personave, mediat kanë përdorur terma të ndryshëm ofendues dhe nënçmues, pa pasur për bazë të drejtat e këtyre personave. Për më shumë atyre ju publikuan të dhënat e tyre personale (emri, emri babës dhe mbiemri) dhe gjendja shëndetësore e tyre duke aluduar në sëmundje psikike, pavarësisht faktit se ata nuk ishin kategorizuar me sëmundje të tilla. Prandaj këto veprime të mediave bien ndesh me parimet Kushtetuese, me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të zbatueshme drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës, si dhe mbi ligjet e aplikueshme në Kosovë.
67. Në praktikën e gjykatave të vendeve evropiane është vërejtur kryesisht një tendencë e përcaktimit të kriterëve që ndihmojnë ndërtimin e një standardi për të vendosur rastet që kanë të bëjnë me lirinë e shprehjes dhe kufijtë e saj. Si shembull mund të përdorim standardin e vendosur nga Gjykata e Kasacionit në Itali (Gjykata e Lartë) në raport me garantimin e të drejtave të tjera, sidomos mbrojtjen e dinjitetit të njeriut nga shpifjet dhe fyerja, e cila me qëllim të kufizimit të lirisë së shprehjes ka përcaktuar tri kriterë bazike, si: vërtetësia, vetëpërmbajtja dhe interesi publik.

Qasje diskriminuuese

68. Neni 24 i Kushtetutës, ndalon diskriminimin, duke theksuar që në paragrafin e parë se “*Të gjithë janë të barabartë para ligjit*”. Tutje Kushtetuta garanton shprehimisht se askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal. Në këtë drejtim Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi përcakton qartazi se **diskriminimi i drejtpërdrejtë** konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji. Në një situatë të tillë të krahasueshme personat që përfituan statusin e “*Invalidit të Luftës së UÇK*”-së, e të angazhuar si zyrtarë policor u trajtuan ndryshe nga personat tjerë që punojnë institucione tjera shtetërore dhe që po ashtu janë përfitues të statusit të “*Invalidit të Luftës së UÇK*”-së.
69. Në këtë drejtim, neni 14 i KEDNJ-së përcakton ndalimin e diskriminimit duke përcaktuar se gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në KEDNJ duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose **çdo status tjetër**. Koncepti i diskriminimit nënkupton që “*Diskriminim*” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze, që ka për qëllim apo efekt të zhvleftësoj ose cenoj njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët. Në rastin tonë prokuroria nuk ka filluar asnjë proces hetimor ndaj zyrtarëve tjerë të punësuar në institucionet publike të Republikës së Kosovës (shih paragrafin 13), përfshirë edhe ato të forcave të armatosura dhe zjarrfikësit si profesione të krahasueshme, prandaj në një situatë të tillë mund të flitet për një qasje në dukje diskriminuuese.

Mungesa e mjeteve juridike efektive

70. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDCP) në nenin 2 përcakton që çdo shtet palë i këtij Pakti zotohet të sigurojë që çdo person, kur t’i shkelen të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Pakt, të ketë **të drejtën e një mjeti juridik efektiv**, edhe atëherë kur shkeljen e kryejnë personat me rastin e ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare. Në nenin 26 PNDCP-ja përcakton që të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtë mbrojtjeje të barabartë të ligjit, pa kurrfarë dallimi.
71. Po ashtu KEDNJ në nenin 13 përcakton që çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare. Legjislacioni penal i Republikës së Kosovës, prokurorit të shtetit i ofron diskrecion lidhur me iniciimin e hetimit apo autorizimin e policisë për mbledhjen e informatave, prandaj një numër i madh i rasteve që i takojnë fazës parapenale apo fazës së hetimit në procedurën penale, trajtohen nga prokuroria pa asnjë lloj kontrolli gjyqësor dhe të dyshuarit në këtë fazë nuk kanë asnjë lloj mjeti juridik në dispozicion që të mund të mbrohen nga arbitrariteti. Mungesa e mjetit juridik nga ana e të dyshuarit në këtë fazë të procedurës nuk garanton siguri juridike për të drejtat dhe liritë e qytetarëve të Republikës së Kosovës, për shkak se ndaj tyre mund të inicohen dhe zhvillohen procedura parapenale të cilat zgjasin me

vite, duke i mbajtur ata në ankth, sikurse në rastin që po e trajton ky Raport, prandaj këto veprime të prokurorisë dhe IPK-së përbëjnë shkelje të nenit 13 të Konventës.

72. Në rastin *Husayn (Abu Zubaydah) v. Poland*¹⁵ kërkuesi u ankua se autoritetet polake, duke shkelur nenin 13 të marrë veçmas dhe në lidhje me nenet 3, 5 dhe 8 të Konventës, kishin mohuar të drejtën e tij për një mjet efektiv për shkak të dështimit për të kryer një hetim efektiv lidhur me pretendimet e tij për shkelje të Konventës. Në rastin *Wille kundër Liechtenstein* 28396/95|Gjykata (Dhoma e Madhe) 28/10/1999 komisioni gjeti se Qeveria nuk kishte arritur të tregonte se kundër shkeljes së nenit të Konventës të pretenduar nga kërkuesi, ka ekzistuar një mjet i efektshëm në praktikë bazuar në të drejtën e Lihtenshtajnit. Në veçanti, lidhur me një ankesë në Gjykatën Kushtetuese, Qeveria nuk kishte paraqitur ndonjë shembull që tregonte aplikimin e saj në një rast të ngjashëm dhe aktual. Në rastin konkret shihet se kemi situatë të krahasueshme pasi që zyrtarët policorë përfitues të beneficionit financiar të “*Invalidit të Luftës së UÇK-së*”, mbahen në hetime parapenale/fazën e mbledhjes së informatave nga prokuroritë dhe IPK-ja me vite të tëra dhe ata nuk kanë asnjë mjet juridik efektiv për ta kundërshtuar këtë.

Cenimi i privatësisë dhe të dhënave personale

73. Ligji Nr. 04/L-125, për Shëndetësi përcakton qartë se pronari të dhënave shëndetësore është institucioni shëndetësor që bën regjistrimin e tyre dhe i njëjti është përgjegjës për grumbullimin, ruajtjen dhe menaxhimin e të dhënave në mënyrë të rregullt dhe të sigurt, sigurimin e qasjes së lehtë në të dhëna, mbrojtjen dhe konfidencialitetin e të dhënave personale dhe mbrojtjen e të dhënave nga keqpërdorimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi (shih nenin 52). Ligji Nr.2004/38 për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Qytetarëve në Kujdesin Shëndetësor, përcakton qartazi se qytetari ka të drejtë në ruajtjen e konfidencialitetit dhe privatësisë së të dhënave personale, të informatave që janë të lidhura me gjendjen e tij shëndetësore, trajtimin mjekësor si dhe çdo informata tjetër, që përmban dokumentacioni i tij shëndetësor duke i lënë në diskrecionin e plotë atij (qytetarit) që të bëjë deklaratë përkitazi me atë se kush mund të marrë informata mbi sëmundjen e tij dhe prognozën e saj, si dhe kush nuk ka të drejtë të jetë i njoftuar plotësisht ose pjesërisht mbi të dhënat e shërimit të tij (neni 20). Ky raport padyshim se do ta trajtojë aspektin shëndetësor të zyrtarëve policorë në kuptim të cenimit të privatësisë së tyre si pasojë e rrjedhjes së informatave, pasi që u pa më lartë se ata ishin lajm kryesor në ballina portalesh me emra, e shprehje të ndryshme ofenduese.
74. Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, termin “*E dhënë personale*” e përkufizon si çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm (subjekt i të dhënave); një person fizik i identifikueshëm është ai, i cili, mund të identifikohet drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, veçanërisht duke iu referuar një identifikuesi në bazë të një emri, një numri identifikimi, të dhënave rreth vendndodhjes, një identifikues online, ose një apo më shumë faktorë specifikë për identitetin fizik, psikologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose social të atij personi fizik, ndërsa termin “*Klasifikim i të dhënave personale*”, e përkufizon si shënjimi i të dhënave personale për të treguar natyrën e tyre të ndjeshme. Ligji përcakton që të dhënat e klasifikuara duhet përcaktuar kushtet sipas të çilave, përdoruesi mund të bëjë përpunimin e tyre, prandaj klasifikimi duhet të mbetet i bashkëngjitur me të dhënat personale të ndjeshme deri në fshirjen, asgjësimin, shkatërrimin ose anonimizimin e tyre, ndërsa lidhur me termin “*Të dhëna personale të ndjeshme*” përkufizohen si të dhëna personale që zbulojnë origjinën etnike ose racore, pikëpamjet politike ose filozofike, përkatësinë fetare, anëtarësimin

¹⁵ https://hudoc.echr.coe.int/eng#_Toc393886343

në sindikatë ose **çdo e dhënë për gjendjen shëndetësore** ose jetën seksuale, çfarëdo përfshirje në ose heqje nga evidencat penale ose të kundërvajtjeve që ruhen në pajtim me ligjin.

75. Vlen të theksohet se edhe Ligji Nr. 03/L-172, për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili u shfuqizua nga Ligji Nr. 06/L-082, për Mbrojtjen e të Dhënave Personale kërkonte që të dhënat personale të ndjeshme duhet të mbrohen në mënyrë të veçantë dhe të klasifikohen me qëllim të parandalimit të qasjes dhe përdorimit të paautorizuar të palëve të treta, me përjashtim të rasteve të përcaktuara me ligj. Nga ajo që tha më sipër shihet se përkundër faktit që autoritet shtetërore kishin detyrim ligjor të mbrojnë të dhënat shëndetësore të këtyre personave një veprim i tillë nuk ka ndodhur në praktikë, pasi që së paku prej 16 nëntorit të vitit 2016, mediat kanë filluar të shkruajnë ndër tjera se: "... *Policia dhe Ushtria nuk mbahen me invalidë*¹⁶". Ligji përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe themelon institucionin¹⁷ që është përgjegjës për mbikëqyrjen e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave dhe përkufizon të drejtën në kompensim të çdo personi, i cili ka pësuar dëm material ose jomaterial, si rezultat i një shkeljeje të këtij Ligji, nga kontrolluesi ose përpunuesi i të dhënave personale.

E drejtë e fituar

76. Përveç asaj që u tha më lartë, Avokati i Popullit rikujton se autoritet gjegjëse nuk e kishin parasysh faktin se e drejta për të gëzuar pensione, në veçanti e drejta në beneficion të invalidit të luftës së UÇK-së, në rastin e zyrtarëve policorë është **e drejtë e fituar (acquired right)**. Kjo doktrinë juridike përcakton që një e drejtë e fituar në bazë të normave ligjore të caktuara nuk mund të kufizohet me ligje apo akte të nxjerra më vonë dhe e njëjta lidhet ngushtë me parimin e sigurisë juridike. Prandaj, tentativat e autoriteteve gjegjëse për kufizimin e drejtës në beneficion të invalidit të luftës së UÇK-së, ndaj zyrtarëve policorë shkel parimin e sigurisë juridike për shkak se kjo e drejtë është fituar në bazë të ligjeve të mëparshme.
77. Vlen të theksohet se me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/66, datë 21 Dhjetor 2000, për herë të parë u rregullua çështja e beneficionit për kategorinë e "*Invalidit të luftës*" dhe atëherë e drejta në pension u njihej personave me invaliditet mbi 40%, prandaj meqenëse shumica prej zyrtarëve policor prej atëherë ishin vlerësuar me 20 % shkallë invaliditeti, atyre i'u ishin refuzuar kërkesat për beneficion. Me ndryshimet legislative të vitit 2006¹⁸ zyrtarët policorë me shkallë të invaliditetit prej 20-30 % e fituan të drejtën në pensionin invalidor personal, derisa Ligji nr. 03/L-035 për Policinë, u miratua nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 20 shkurt 2008 dhe i njëjti u shpall në Gazetën Zyrtare nr. 28, më qershor të vitit 2008. Derisa jemi te e drejta në pensionin invalidor personal, është me rëndësi të theksohet se Ligji nr. 04/L-172, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës, Viktimave Civile dhe Familjarëve të tyre, e ka përcaktuar Invalidin e luftës së UÇK-së si: "*Luftëtari, pjesëtari dhe i internuari (burgosuri) i UÇK- së, i cili ka pësuar plagë, lëndime (dëmtime) fizike dhe psikike apo sëmundje të rënda gjatë luftës ose në burgjet dhe kampet e armikut, gjatë periudhës së luftës, me shkallë të invaliditetit së paku 10%*".

¹⁶Shih linkun: <https://zeri.info/aktuale/117151/ne-polici-punojne-cdhe-invalidet-e-luftes/>

¹⁷Ligji nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale përcakton që Agjencia për Informim dhe Privatësi (Agjencia) është agjenci e pavarur, përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për qasje në dokumente publike dhe mbrojtje të të dhënave personale, me qëllim që të mbrohen të drejtat dhe liritë themelore të personave fizikë, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, si dhe garantimin e qasjes në dokumente publike.

¹⁸ Shih: Ligji Nr. 02/L-2 për Statusin dhe të Drejtat e Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve dhe Pjesëtarëve të UÇK-së dhe Familjeve të Viktimave Civile të Luftës (neni 8, paragrafi 8.10).

78. Avokati i Popullit rikujton se si pjesë përbërëse e parimit të sigurisë juridike, garantohet edhe parimi i pritjes legjitime. Në bazë të doktrinës së pritjes legjitime, ata të cilët veprojnë me mirëbesim dhe në përputhje me ligjin, nuk duhet të jenë të frustruar nga pritjet e tyre legjitime. Kjo doktrinë nuk gjen zbatim vetëm në procedurat e nxjerrjes së ligjeve, por edhe në nxjerrjen e vendimeve në rastet individuale nga autoritetit publike. Po ashtu, siguria juridike nënkupton që ligji të jetë i qartë dhe i zbatueshëm dhe që ai zbatohet në praktikë¹⁹. Sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane (shih rastet *Kopecky v. Slovakia*, Aktgjykimi i datës 28 shtator 2004, para 45-52; *Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke (dec.)*, nr. 39794/98, para 73, GJEDNJ 2002-VII), “pritja legjitime” duhet të jetë e një natyre konkrete dhe duhet të bazohet në dispozita ligjore ose në akte ligjore.
79. Lidhur me çështjen e pensioneve si drejtë në pronë Avokati i Popullit më 27 shkurt 2018, publikoi Raport²⁰ me rekomandime lidhur me pensionet kontribut pagues. Raporti kishte për qëllim të tërheqë vëmendjen MPMS-së, që qytetarëve t’iu ofrohet mundësia e garantuar ligjore dhe kushtetuese në shfrytëzim të pensioneve si e drejtë në pronë. Tutje Raporti analizoi kornizën ligjore në aspektin e ushtrimit të së drejtës në pension kontribut pagues të moshës, në raport me të drejtën në ushtrimin e pensioneve tjera në bazë të Ligjit Nr.04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre dhe Ligjit Nr.04/L-261 për Veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në këtë drejtim, Raporti argumentoi se ushtrimi i të drejtës në pensionin paraqet ushtrim të së drejtës në pronë, në bazë të nenit 1, Protokollit Nr.1 të KEDNJ-së, në raport me kushtëzimin e ushtrimit të së drejtës në këtë pension, në bazë të nenit 8 të Ligjit Nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti.

Konstatimet e Avokatit të Popullit

80. Avokati i Popullit konstaton se ka shkelje të të drejtës për një proces të drejtë, e cila përbën një nga të drejtat themelore të njeriut, meqë autoritet përkatëse nuk i kanë përmbushur detyrimet Kushtetuese dhe ligjore si dhe standardet ndërkombëtare të aplikueshme në Republikën e Kosovës, kundrejt ndërmarrjes së veprimeve hetimore ndaj zyrtarëve të dyshuar.
81. Avokati i Popullit konstaton se organet kompetente, nuk inicuan asnjë lloj hetimi për të kuptuar se si rrodhën këto informacione nga dosjet e DFDLV/MPMS-së. Cili ishte qëllimi i publikimit të këtyre të dhënave? Sa u dëmtua reputacioni i tyre duke marrë parasysh se një numër i konsiderueshëm i këtyre zyrtarëve janë me grada të larta dhe pozita udhëheqëse në PK? Prandaj, në rrethana normale të një shoqërie demokratike veprime të tilla nuk do të kalonin pa pasoja juridike ndaj personave përgjegjës, ndërsa të dëmtuarve në këtë proces do duhej t’i ofrohej kompensim si shpërblim ndaj dëmit material dhe jo material siç edhe e përcakton Ligji nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
82. Avokati i Popullit konstaton se ekziston një qasje selektive në hetimin e kësaj çështje nga prokuroria. Në një situatë të tillë të krahasueshme personat që përfituan statusin e “*Invalidit të Luftës së UÇK*”-së, e të angazhuar si zyrtarë policor u trajtuan ndryshe nga personat tjerë që punojnë institucione tjera shtetërore dhe që po ashtu janë përfitues të statusit të “*Invalidit të Luftës së UÇK*”-së.

¹⁹ EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION) REPORT ON THE RULE OF LAW Adopted by the Venice Commission at its 86th plenary session (Venice, 25-26 March 2011) (44-51).

²⁰ Shih linkun: <https://www.oik-rks.org/2018/02/27/raport-me-rekomandime-a-890-2016-te-drejtjen-ne-pension-kontribut-pagues-te-moshes-si-dhe-e-drejta-ne-shfrytezimin-e-pensioneve-te-tjera-te-aplikueshme-ne-kosove/>

83. Avokati i Popullit konstaton se janë përdorë standarde të dyfishta për situata të ngjashme. Sipas procedurës, secili person që pretendon se i takon kjo e drejtë statusore e pensionit/beneficionit aplikon për t'iu njohur e drejta invalidore dhe i njëjti duhet të kalojë përmes verifikimit në komisionet mjekësore të MPMS-së të cilët pasi vendosin për secilin rast veç e veç, japin vlerësimet e tyre, e pastaj departamenti përkatës i MPMS-së lëshon vendim me të cilin e njofton palën se ju ka pranuar apo ju ka refuzuar kërkesa. Pra e gjithë barra e vlerësimit bie mbi komisionet profesionale, prandaj në situatë të krahasueshme përkitazi me veteranët e luftës së UÇK-së prokuroria kompetente kishte ngritur aktakuzë ndaj komisionit qeveritar, ndërsa në rastin që po e trajton ky Raport prokuroria dhe IPK-ja po hetojnë ndaj përfituesit

84. Avokati i Popullit konstaton se publikimi i të dhënave personale dhe sidomos zbulimi i identitetit të personave të dyshuar përmes mediave, pa një kujdes të shtuar cenon dinjitetin e palëve në procedurë penale dhe shkelë parimin e prezumimit të pafajësisë së të pandehurve.

Në pajtim me nenin 135, paragrafin 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: “...ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore” dhe në pajtim me nenin 18, paragrafin 1 pika 1.2 të Ligjit për Avokatin e Popullit “të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla” si dhe bazuar në ato që u thanë më sipër në këtë raport Avokati i Popullit:

REKOMANDON

Prokurorinë e Shtetit të Republikës së Kosovës dhe Inspektoratin Policor të Kosovës që:

- Në pajtim me kompetencat dhe autorizimet ligjore sa më parë të përmbyllin hetimet lidhur me çështjen e zyrtarëve policorë që trajtoi ky raport në mënyrë që kjo çështje të marr epilog të qartë, qoftë nëpërmjet ngritjes së aktakuzës dhe parashtrimin e çështjes para gjykatës, qoftë me pushimin e hetimeve.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht që të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,


Hilmi Jashari

Avokat i Popullit